



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry
Kabineti i Ministrit-Kabinet Ministra-Cabinet of the Minister

REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIJË-MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE-MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY			
Nr. Njësia Org. Org. Simbol Org. Unit	01	Nr. Prot. Proj. Prot. Proj. No.	3485
Nr. ifaqeve Proj. ifaqeve	02	Data Datim	09.07.2020

01.Ref.Nr.02
Prishtinë, 09.07.2020

Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), në mbështetje të neneve 10, 11 dhe 17 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcës 8 pikat 20, 30 e 31 të Rregullores (QRK) nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, duke pasur parasysh kërkesat e Planit Kombëtar të Reagimit, rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike dhe Manualin për mbrojtje nga përhapja e virusit COVID-19, nxjerr këtë:

URDHËRESË

Për mbarëvajtjen e veprimtarive ekonomike gjatë pandemisë COVID-19

- Urdhërohen të gjithë operatorët ekonomikë për zbatimin e masave të Qeverisë së Kosovës të përcaktuara me vendimin nr. 01/10, të datës 05.07.2020, për luftimin e COVID-19.
- Çdo operator ekonomik që lejohet të veprojë sipas kësaj urdhërese duhet të marrë këto masa higjienike e parandaluese:
 - Të dezinfektojë dhe të ajrosë rregullisht lokalit dhe hapësirën e punës;
 - Të pajisë punëtorët me mjete mbrojtëse personale, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar për Shëndetësi Publike;
 - Të marrë masa për distancën fizike dhe shmangien e kontaktit minimum 1.5 metra, për punonjësit dhe për klientët, sipas rekomandimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar për Shëndetësi Publike;
 - Të ketë dezinfektantë të qasshëm lehtë nga klientët në çdo lokal.
 - Të marrë masat e tjera të nevojshme për të zbatuar vendimet e Qeverisë lidhur me pandeminë COVID-19.
- Prodhuesit, përpunuesit, ndërtimtarët dhe veprimtaritë e tjera tregtare dhe shërbyese mund të ushtrojnë veprimtaritë e tyre, duke ndërmarrë masat nga pikat 2.1, 2.2, 2.3, 2.4 dhe 2.5 edhe gjatë orarit 21:00-05:00.
- Obligohet Administrata Tatimore e Kosovës që të lëshojë lejen e qarkullimit EDI për të gjithë operatorët ekonomikë në mënyrë që të ju mundësohet lëvizja në orarin 21:00-05:00.
- Detyrohen inspektorët e tregut, inspektorët sanitar dhe inspektorët e punës në tërë territorin e Republikës së Kosovës që të shqyrtojnë me përparësi rastet që lidhen me zbatimin e vendimit të Qeverisë nr. 01/10, të datës 05.07.2020 dhe kësaj urdhërese.
- Kjo urdhëresë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Veseli KRASNIQI

Ministër



U dërgohet:

- Kabinetit të Ministrave të MTI-së
- Zyrës së Kryeministrit
- Zëvendëskryeministrave
- Të gjithë ministrave (ministrive);
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Inspektoratit të Tregut;
- Inspektoratit të Punës;
- AVUK-it;
- Inspektorateve komunale;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit.